



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 1488 Prot.

Tiranë, më 05.11.2024

URDHËR

Nr. 51, datë 05/11/2024

MBI

**MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR ORGANIZIMIN DHE
ADMINISTRIMIN E KONKURSEVE TË PRANIMIT CIKLI III-të
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22/7/2015 *Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24/1/2018 *Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*, i ndryshuar, Urdhërin e MAS Nr. 127, datë 16/3/2022 *Për Hapjen e Programit të Studimit të Ciklit të Tretë Doktoratë në "Arte Skenike"*, në Universitetin e Arteve të Tiranës, Urdhërin e MAS Nr. 128, datë 16/3/2022 *Për Hapjen e Programit të Studimit të Ciklit të Tretë Doktoratë në "Muzikologji"*, në Universitetin e Arteve të Tiranës, Urdhërin e MAS Nr. 668, datë 5/12/2023 *Për Hapjen e Programit të Studimit të Ciklit të Tretë Doktoratë në "Arte Pamore"*, në Universitetin e Arteve të Tiranës, Udhëzimin e MAS Nr.52, datë 03/12/2015 *Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë*, i ndryshuar

URDHËROJ:

Organizimi i konkurseve të pranimit për studime në ciklin e tretë për fitimin e gradës shkencore "Doktor", në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Arteve, zhvillohet si më poshtë vijon:

1. Në **datën 7 Nëntor 2024** fakultetet pranë Universitetit të Arteve dorëzojnë në rektorat kriteret, procedurat dhe afatet për konkurset e pranimit në zbatim të urdhërit të Rektorit të UART dhe të rregulloreve përkatëse për programet e studimit të Ciklit III.
2. Në **datën 9-10 Dhjetor 2024 ora 08:00-16:00**, kandidatët për konkurset e pranimit në Ciklin III për fitimin e gradës shkencore "Doktor" regjistrohen pranë sekretarive përkatëse në Universitetin e Arteve.

3. Në **datat 17-18 Dhjetor 2024** fakultetet e Universitetit të Arteve organizojnë zhvillimin e konkurseve të pranimit;
4. Në datën **19 Dhjetor 2024** kryhet publikimi i listave të fituesve në fakultetet përkatëse dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve;
5. Në **datën 23 Dhjetor** kandidatët që nuk janë shpallur fitues mund të paraqesin ankimimin drejtuar dekanit të fakultetit përkatës.
6. Në **datën 24 Dhjetor 2024 nga ora 08:00 deri në orën 16:00**, në rast të mospasjes së ankimimeve, kryhet regjistrimi i kandidatëve fitues pranë sekretarive mësimore të fakulteteve përkatëse të Universitetit të Arteve.
7. Në **datën 26 Dhjetor 2024** publikohen listat e kandidatëve të regjistruar.
8. Të afishohen në mjediset e secilit Fakultet të UART, Urdhërat/Vendimet mbi masat e marra për konkurset e pranimit, kriteret, procedurat dhe afatet e konkurseve të pranimit, si dhe çdo procedurë tjetër e nevojshme për këtë proces.
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri; Administratori i UART; Dekanët e Fakulteteve të UART; Përgjegjësit e Njësive bazë të Fakulteteve të UART; Sekretaritet mësimore të Fakulteteve të UART; Drejtoria Ekonomike e UART; Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit, Statistikave, Juridike dhe Protokoll Arkivës; Drejtoria e Bibliotekës së UART; Sektori Mësimor dhe i Kurikulës, Informimit dhe Këshillimit të Studentëve, Alumni; Sektori i Teknologjisë së Informacionit; Sektori i Statistikave; Sektori i Shërbimeve dhe çdo strukturë tjetër në ndihmë të këtij procesi.
10. Ky Urdhër të shpallet në faqen elektronike zyrtare të Universitetit të Arteve

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Erald Bakalli

REPUBLICA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI I ARTVE
TIRANË